REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 703/6 prot. Tiranë më 19.8.2021

REKOMANDIM

Nr. 42, datë 19.8.2021

PËR KONTROLLUESIN "DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJENDJES CIVILE"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), relacionit të hetimit administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve, datë 19.08.2021 (në vijim, "*Relacioni i Hetimit Administrativ*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile*" (në vijim, "*Kontrolluesi*" dhe/ose "*DPGJC*"),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 46, datë 19.04.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Komisioneri*"), u krye hetimi administrativ kryesisht, pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Verifikim lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, nisur nga informacionet e publikuara në median elektronike.*

Zyra e Komisionerit, bazuar në pikat 1.2 dhe 1.6 të Pjesës 1, si dhe Pjesën 2, të Relacionit të Hetimit Administrativ, si dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Nga krahasimi i të dhënave që Kontrolluesi vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore, bazuar në nenin 60 të Kodit Zgjedhor, me ato të një baze të dhënash objekt hetimi (data_tirana_2021_Backup_Backup.accdb), në të cilën rezultojnë të përpunuara të dhënat personale të 91 061 (*nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e një*) subjekteve të të dhënave (në vijim, "*Baza e të Dhënave*"), rezulton se të dhënat personale (përbërësit zgjedhorë) që Kontrolluesi transmeton tek subjektet në fjalë përkojnë me 6 kategori të dhënash të Bazës së të Dhënave (nga 20 të tilla). Konkretisht, emri, atësia, mbiemri, datëlindja, numri personal dhe shtetësia.

Rrjedhimisht, Zyra e Komisionerit, konstaton se 30% e Bazës së të Dhënave përbëhet nga të dhëna që origjinarisht Kontrolluesi iu transmeton subjekteve zgjedhore në bazë të nenit 60 të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, nga përgjigjet e Kontrolluesit, rezulton se akses në të dhënat që përpunon ai, përfshirë këtu përbërësit zgjedhorë të sipërpërmendur, mund të aksesohen nga shoqëria koncesionare ALEAT, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (në vijim, "*AKSHI*").

Më tej, referuar Udhëzimit të përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Brendshëm "*Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin, specifikisht sipas aneksit I, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi "Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 463*"), rezulton se janë 36 kontrollues të tjerë, të cilët në mbështetje të këtij udhëzimi kanë akses, sipas të drejtave të paracaktuara në kuadër të detyrimeve ligjore përkatëse.

Bazuar në pikën 7 të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*" i ndryshuar (në vijim, "*VKM nr. 673*"), AKSHI është përgjegjës për ekspozimin e *web service*-ve të bazave të të dhënave me qëllim aksesimin e të dhënave parësore për subjektet e interesuara për ndërveprimin në platformën qeveritare të ndërveprimit.

Nga ana tjetër, më datë 09.04.2021, përpara publikimit mediatik të çështjes objekt hetimi, Zyra e Komisionerit i është drejtuar me shkresë, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Kontrolluesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për bllokimin si dhe fillimin e procedimit ligjor për personat/subjektet që qëndrojnë pas faqes së internetit https://gjendjacivile.blogspot.com/p/falas.html, si dhe lidhjeve (links) të aksesueshme përmes kësaj faqeje interneti, pasi në të rezultonte të vijonte publikimi i të dhënave personale të marra nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, i përditësuar deri në vitin 2008.

Vlen të theksohet se kjo problematikë është konstatuar edhe më herët, siç rezulton nga hetimi administrativ i filluar kryesisht nga Zyra e Komisionerit ndaj Kontrolluesit, në vitin 2019, në përfundim të të cilit, Zyra e Komisionerit ka dalë me Rekomandimin nr. 26, datë 05.04.2019, ku, ndër të tjera, ka lënë një sërë detyrash për zbatim nga ana e Kontrolluesit.

Rrjedhimisht, për një pjesë të shtetasve, të dhënat e të cilëve janë të përpunuara në Bazën e të Dhënave, rezultojnë të aksesueshme në mënyrë të paligjshme edhe në faqen e mësipërme të internetit.

Bazuar në veprimet procedurale të ndërmarra sipas Urdhrit nr. 46, datë 19.04.2021, të Komisionerit për kryerjen e hetimit administrativ pranë Kontrolluesit, të cilat përshijnë, të tilla si, konstatimet në vend dhe shqyrtimi i bazës ligjore dhe akteve të brendshme të kontrolluesit në fjalë, si dhe referuar nivelit të ulët të përputhshmërisë së kategorive të të dhënave personale që përpunon ky Kontrollues, me ato të përpunuara në Bazën e të Dhënave, numrit të papërcaktueshëm të marrësve të të dhënave personale të Kontrolluesit (sidomos në rastin e përbërësve zgjedhorë, të cilët përpunohen (kupto: shpërndahen) më tej nga subjektet zgjedhore), si dhe qarkullimit masiv të Bazës së të Dhënave, si dhe publikimeve të paligjshme në faqen e internetit https://gjendjacivile.blogspot.com/p/falas.html, nuk u bë e mundur të provohet nëse Baza e të Dhënave është populluar me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, si rezultat i veprimeve të paligjshme të Kontrolluesit;

2. Nga ana tjetër, bazuar në pikën 1.2 dhe 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ, Zyra e Komisionerit konstaton një sërë elementësh që nuk janë konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga ky kontrollues, ndër të tjera, si vijon:

   (i) Në lidhje me institucionet të cilëve ju është ofruar shërbimi (akses) në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në raport me institucionet e parashikuara për të patur askses/shërbim në këtë regjistër, sipas Udhëzimit nr. 463.

   Rezulton se janë 47 institucione publike/private të cilët kanë akses në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (pika 1.2 e Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ).

   Në bazë të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, DPGJC është kontrollues i të dhënave personale që përpunon ato për përmbushjen e qëllimit dhe detyrave të saj institucionale, përfshirë edhe sa parashikohet në Udhëzimin nr. 463.

   Për këtë arsye, bazuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kontrolluesi bart detyrimin kryesor për marrjen e masave tekniko-organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, si dhe ndalimin e aksesit të paligjshëm në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

   Nga përgjigjet e Kontrolluesit, në lidhje me çështjet e parashtruara me shkrim nga Zyra e Komisionerit, rezulton se, për të, aspektet e sigurisë së të dhënave dhe marrëdhënieve me përpunues të tjerë (përfshirë mirëmbajtës) mbulohen nga AKSHI.

   Zyra e Komisionerit vlerëson se angazhimi i përpunuesve/bashkëkontrolluesve të tjerë (të përcaktuar me akt nënligjor) nuk çliron Kontrolluesin nga përgjegjësitë për të mbikëqyrur dhe monitoruar aspektet e sigurisë dhe

konfidencialitetit të të dhënave që Kontrolluesi është i autorizuar (me ligj) të përpunojë dhe administrojë;

(ii) Bazuar në dispozitat e udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*)", kontrolluesit janë përgjegjës për krijimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, qoftë kur përpunojnë të dhënat me kapacitetet e tyre teknike dhe njerëzore, qoftë kur për ruajtjen e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave angazhohen subjekte të tjera – rast në të cilin kontrolluesi është i detyruar të veprojë edhe në përputhje me dispozitat e nenit 20 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Për rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 19*").

Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit "*Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 48*"), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;

(iii) Gjithashtu, Zyra e Komisionerit konstaton një mosrespektim të germës "a" të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili parashikon përgjegjësinë e kontrolluesve publikë (përfshi këtu, Kontrolluesin)

për të kërkuar mendim/opinion nga Zyra e Komisionerit për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga këta kontrollues, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve, si dhe ankesave të paraqitura ndaj Kontrolluesit, në respektim të së drejtës të tij për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi u paraqit në seancë dhe, në lidhje me çështjet e ngritura nga Zyra e Komisionerit, ka disponuar me shkrim, ndër të tjera, si vijon:

"*Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka përgjegjësinë e kontrollorit mbi përpunimin e të dhënave personale të shtetasve dhe bashkëpërcaktues me AKSHI-n, për mënyrën e transmetimit të tyre ndaj institucioneve që mund t'i përfitojnë elektronikisht.*

Çështja e gjurmimit të të dhënave mbetet një ndër angazhimet dhe prioritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të verifikuar dhe kontrolluar, informacionin e vënë në dispozicion ndaj organeve të tjera, të cilat legjitimohen në kërkimin e tij.
Në këtë kuadër, DPGJC duhet të gjurmojë sipas destinacionit përfundimtar të kalimit të të dhënave, qasjes monitoruese, për të cilat do të zhvillojmë veprimtarinë audituese të monitorimit, avancimeve të teknologjisë, për përhapjen e paligjshme të të dhënave me qëllim shmangien e çdo risku në përpunimin e tyre nga palët e legjitimuara në kërkimin e informacionit.

Në këtë drejtim do të vijohet me përcjelljen e komunikimeve shkresorë për qasjen monitoruese që do të zhvillohet ndërmjet autoriteteve më të larta në Ministrinë e Brendshme dhe Agjencinë Kombëtare të Informacionit (AKSHI)-n. Deri më tani për këtë çështje, DPGJC ka patur komunikim elektronik me AKSHI-n, në nivelin e drejtuesve të DPGjC-së.".

Zyra e Komisionerit vlerëson gatishmërinë dhe bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit administrativ, si dhe angazhimin serioz të tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7, 18, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa "a/1"), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e Ligjit, si dhe të marrë masa për adresimin e konstatimeve

të Komisionerit sipas pikave 1.2 dhe 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ.

Për këtë arsye, Kontrolluesi duhet:

(i) të ndërmarrë nisma për përmirësimin e njohurive ligjore dhe teknike për adresimin e kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ndër të tjera, nëpërmjet trajnimit të punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese dhe në drejtim të konsolidimit të praktikave dhe legjislacionit specifik që rregullon veprimtarinë e tyre;

(ii) të ndalojë aksesin në të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile për kontrolluesit të cilët nuk përmbushin kërkesat e Udhëzimit nr. 463;

(iii) të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19;

(iv) të ketë në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve që i ngarkon legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, në harmoni me legjislacionin sektorial, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave.

Për këtë arsye, përveç njohjes dhe adresimit të aspekteve materiale të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale (të tilla si, por pa u kufizuar, parimet, kriteret ligjore, si dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave), Kontrolluesi duhet të zbatojë edhe detyrimet që lidhen me masat tekniko-organizative, të cilat synojnë të garantojnë sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Në lidhje me këtë aspekt, rekomandohet një koordinim dhe bashkëpunim i pandërprerë midis Kontrolluesit dhe AKSHI-t, me qëllim që të garantohet një nivel maksimal i sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, identifikimi dhe gjurmimi i niveleve të aksesit dhe respektim i Udhëzimit nr. 463;

(v) me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 – në harmoni me nenet 27 dhe 28 të Ligjit –, sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale (përfshirë sa parashtrohet në germat (i) deri (ix) të pikës 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ).

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij

udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të germës "b" të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

(vi) Për përmbushjen e rekomandimeve sipas germave (i), (iv) dhe (v) më sipër, rezulton i domosdoshëm investimi në kapacitete të burimeve njerëzore dhe teknike, si dhe planifikimi i burimeve të nevojshme financiare;

2. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme respektimin e detyrimeve të tij sipas germës "a" të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit, për të kërkuar mendim/opinion nga Zyra e Komisionerit për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga këta kontrollues, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë;

3. Përveç sa rekomandohet shprehimisht në pikat 1 dhe 2 më sipër, Kontrolluesi duhet të adresojë të gjitha rekomandimet e tjera, që i zbatohen specifikisht atij, sipas pikave 1.2 dhe 1.6 të Pjesës 1 të Relacionit të Hetimit Administrativ;

4. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

   (i) Në vazhdimësi, detyrimet e parashikuara në germat (i), (iii) (iv) dhe (v) të pikës 1, si dhe detyrimet e parashikuara në pikat 2 dhe 3, më sipër;

   (ii) Menjëherë, detyrimi i parashikuar në germën (ii) të pikës 1;

5. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 19.8.2021

KOMISIONERI

Besnik Dervishi